



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1171/1 prot.

Tiranë më 9.10.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 6896 Prot., datë 28.09.2020, projektvendimi "*Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore*", në tërësi vlerësohet i hartuar në përputhje me legjislacionin që mbulon fushën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "*Zyra e Komisionerit*").

Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit shpreh vlerësimin e saj për këtë nismë, ndër të tjera edhe për përfshirjen e përdorimit të gjuhës së pakicës kombëtare në kuadër të të drejtave që burojnë nga zbatimi i ligjit nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit*".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

